

07.02.2021
Ora 16:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Rrogozhinë dhe Lushnjë të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Y. Merkaç, I. Osmanaj, E. Meta**
- **Parti Politike:**
- **OJQ: KRIK**

Z. I. Celibashi: Në seancën publike të ditës së sotme kemi në rendin e ditës vetëm një çështje “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Rrogozhinë dhe Lushnjë të datës 6 Mars 2022”. Kush do ta relatojë projektvendimin?

Z. Y. Merkaç: Sipas përcaktimeve të nenit 93 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje. Komisioni Rregullator, me udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, ka caktuar rregullat dhe kriteret që ndiqen në rastet kur kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i propozon KQZ-së caktimin e vendndodhjes së QV në ambiente private.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.02.2022*

Në këtë relacion kemi paraqitur propozimin për vendndodhjen e 128 qendrave të votimit në ambiente private. Kryetarët e bashkive në propozimet e paraqitura kanë referuar mungesën e ndërtesave publike në zonën e qendrës së votimit, apo në zonë qendre votimi fqinje. Është paraqitur dokumentacioni dhe janë referuar të dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pozicioni gjeografik i ndërtesave private të propozuara për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit, përgjithësisht është në qendër/afër qendrës së zonës së qendrës së votimit. Konfirmohet se ndërtesat nuk përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht apo tërësisht, të një partie politike/kandidati/të afërmeve të tij, ose kanë ka shërbyer si zyrë elektorale gjatë fushatës zgjedhore.

Kryetari i Bashkisë Shkodër, propozon për caktimin e vendndodhjes së njëzet e katër qendrave të votimit në ndërtesa private të cilat nuk ndryshojnë nga zgjedhjet e kaluara.

Kryetari i Bashkisë Dibër, propozon nëntë qendra votimi në ndërtesa private të cilat nuk ndryshojnë nga zgjedhjet e kaluara.


Kryetari i Bashkisë Durrës, propozon gjashtëdhjetë e dy qendra votimi në ndërtesa private. Nga të cilat pesëmbëdhjetë ndryshojnë nga zgjedhjet e kaluara, pjesa tjetër është e njëjtë si në zgjedhjet e kaluara.

Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, propozon nëntë qendra votimi në ndërtesa private të cilat nuk ndryshojnë nga zgjedhjet e kaluara.

Kryetari i Bashkisë Lushnje, propozon njëzet e katër qendra votimi në ndërtesa private. Nga të cilat një qendër votimi ndryshon vendndodhjen nga zgjedhjet e kaluara, pjesa tjetër është e njëjtë si në zgjedhjet e kaluara.

Për sa më sipër keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e objekteve private ku do të zhvillohet votimi, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.02.2022*

Z. I. Celibashi: Erjon, edhe njëherë, sa qendra votimi ndryshojnë vendndodhjen në total nga zgjedhjet e kaluara?

Z. E. Meta: Gjashtëmbëdhjetë qendra votimi kanë ndryshuar vendndodhjen, ndërsa njëra ndryshon pronarin, është e njejta vendndodhje.

Z. I. Celibashi: Pra, kanë qenë në ambiente private, do të jenë në ambiente private, por ndryshojnë pronarët? Të lutem edhe njëherë!

Z. E. Meta: Në Durrës kemi pesëmbëdhjetë raste të cilat ndryshojnë nga zgjedhjet e kaluara. Në Lushnje kemi një rast, ndërsa në Rrogozhinë është një rast ku është e njejta vendndodhje, por ndryshon thjesht emri i pronarit.

Z. I. Celibashi: Ndërsa tek të tjerat ndryshon dhe vendndodhja, jo vetëm...

Z. E. Meta: Po!

Z. I. Celibashi: Dakord! Partive politike ua keni dërguar materialin?

Z. E. Meta: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë e miratojmë këtë projektakt sipas draftit të propozuar. Çështje të tjera në rendin e ditës nuk kemi, seanca mbyllet!

Vendimi nr. 47

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

